



Prishtinë, 29.01.2024
Kodi i ZRRE-së: V_1867_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2469_12_23** i dt.01.12.2023;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **28.12.2023**.

në seancën e mbajtur më datë **29.01.2024** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin SH.T nga komuna e Podujevës, si e pa bazuar.
- II. **MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2469_12_23 i dt.01.12.2023.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 01.12.2023 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2469_12_23 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit, me të cilën ankesë e ka kontestuar përgjigjën e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 30.03.2023 lidhur me kontestimin e faturës së energjisë elektrike të muajit nëntor 2022 si dhe korrigjimit nr. 101819DPR-90051556 datë 10.03.2023, për shkak të dyshimit në matjen dhe faturimin jo të saktë me njehsorin elektrik nr. 55273634.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së dhe konstaton se i njëjti është i padrejtë;
- Pretendon se faturimi dhe korrigjimi i konsumatorit është real;
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2469_12_23 i datës 01.12.2023 për konsumatorin SH.T

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Lidhur me pretendimin e KESCO se vendimin nr. ZRRE/DMK_ V_2469_12_23 i datës 01.12.2023 i Departamentit per Mbrojtjen e konsumatorëve nuk është i drejt, Bordi pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe shkresave si: Fatura nr. 11220DPR-90051556 datë 25.11.2022; Ankesa e konsumatorit ne KESCO date 29.11.2022; përgjigja e KESCO-s date 30.03.2023; korrigjimit nr. 101819DPR-90051556 datë 10.03.2023; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 02.08.2023; Vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK_ V_2469_12_23 i datës 01.12.2023, Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike, listat e leximi, ka gjetur se nuk ka dyshime që vendimi i marrë nga DMK-ja është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

ZRrE ka vërejtur se, Departamenti i faturimit ne KESCO me datë 25.11.2022 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën nëntor 2022, me **3,270 kWh** apo e shprehur ne vlerë financiare **335.01€**. Me datë 29.11.2022 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturimin e periudhës nëntor 2022 për shkak të dyshimit në matjen dhe faturimin jo të saktë me njehsorin elektrik nr. 55273634. Pas ankesës se konsumatorit me datë 30.03.2023 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij duke bere korrigjimin e faturave per periudhën 09/2022 deri ne periudhën 11/2022 ne vlerë financiare **-40.98€** per shkak te leximit dhe faturimit jo te saktë.

Bordi i ZRRE ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit dhe konstaton se nga periudha 05/2020 kur edhe është vendosur per matje njehsori elektrik nr. 55273634 shpenzimet e konsumatorit lexohen nga distanca, pra përmes AMR përveç ne periudhat kontestuese 09/10/2022 kur është evidentuar se leximi behet ne mënyrë manuale dhe vlerësuar qe vërteton se konsumatori per këto dy periudha nuk ka pasur lexim te saktë kurse fatura e periudhës 11/2022 nuk mund te paraqet shpenzim real te konsumatorit. Bazuar ne listat e leximit dhe rrjedhën e energjisë elektrike Bordi i ZRRE konstaton se KESCO me rastin e faturimit te konsumatorit per shpenzimet e periudhës 09/10/11/2022 nuk ka vepruar konform nenit nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Bordi i ZRRE ka vërejtur se pas ankesës se konsumatorit, Departamenti i faturimit në KESCO me datë 10.03.2023 përmes korrigjimit nr. 101819DPR-90051556 ka bërë korrigjimin në vlerë **-40.98€** duke bërë korrigjimin për faturat e periudhës 09/2022 deri ne periudhën 11/2022 duke marre per baze se njehsori elektrik nuk ka pasur komunikim nga distanca prej datës 30.08.2022 deri me datë 08.11.2022. Bordi i ZRRE ka shqyrtuar korrigjimin e bere si dhe ka bere shpërndarjen e kWh duke marr per baze se leximi i fundit para periudhës kontestuese është bere me 25.08.2022 dhe konstaton se konsumatorit nuk i takon vlere tjetër financiare per tu korrigjuar mirëpo duke pasur parasysh se kjo shpërndarje ne veçanti per periudhën nëntor nuk përputhët me shpenzimet e konsumatorit konstaton se konsumatorit bazuar edhe ne faktet e tjera te ofruar lidhur me intervenimin e punëtorëve te KEDS duhet ti behet korrigjimi duke marre per baze shpenzimet e me hershme te periudhës 09/10/11/2021.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se i licencuari KESCO në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, e ne veçanti rrjedhën e energjisë elektrik, transaksionet e konsumatorit si dhe nenit 28 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet ne gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Arta Qorolli, anëtare

Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **SH.T** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.